



Prishtinë, 04 tetor 2021
Kodi i ZRRE-së: V_1416_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenin 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, dhe Nenin 32 paragrafin 3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 6 dhe 7 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Nenit 7 dhe Nenit 19 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla Nr.ZRRE/Nr.07/2017);
- Aplikacionin për vazhdim të licencës për prodhim të energjisë elektrike të dorëzuar në Rregullator me datë 01.06.2021 (të korigjuar me 16.09.2021) nga ndërmarrja Korporata Energjetike e Kosovës –Divizioni i Gjenerimit “KEK SH.A.”-TC Kosova “A” , adresa: rruga “Nënë Tereza nr. 36, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës,
- Kërkesën për shtyrje të afatit të licencës për prodhim të energjisë elektrike për TC “Kosova A” e datës 01.06.2021; dhe
- VENDIMIN e lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), të datës 27.09.2021,

në seancën e mbajtur me datë 04 tetor 2021, nxori këtë:

VENDIM

- I. I VAZHDOHET licenca për prodhim të energjisë elektrike Korporatës Energjetike të Kosovës – Divizioni i Gjenerimit (KEK SH.A.)-TC “Kosova A” me numër licence ZRRE/Li_05/17_A, për periudhën dy (2) vjeçare, nga 04 tetor 2021 deri 04 tetor 2023.
- II. Obligohet KEK SH.A. që brenda periudhës së përcaktuar në pikën një (I) të dispozitivit të këtij vendimi të sigurojë Lejen Mjedisore të Integruar nga Ministria përkatëse dhe kopjen e së njëjtës ta dërgojë në Rregullator, njëkohësisht të informoj Rregullatorin mbi masat e marra për sigurimin e kësaj leje nga Ministria përkatëse.
- III. Obligohet ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për KEK SH.A TC “Kosova A” të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.

Arsyetim



- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 01.06.2021 ka pranuar Kërkesën për Vazhdim Licence për prodhim të energjisë elektrike të KEK Sh.a. – Divizioni i Gjenerimit-TC “Kosova A”, për periudhën nga 04.10.2021 deri me 04.10.2022.
- KEK SH.A po ashtu ka dorëzuar Aplikacionin për vazhdim licence për prodhim të energjisë elektrike dhe dokumente/dëshmi shtesë, të kërkuara nga Rregullatori, për vazhdim licence.
- Në pamundësi që KEK SH.A të pajiset me Leje Mjedisore të Integruar nga MMPHI, Bordi i Rregullatorit, që nga viti 2011 për çdo vit i ka vazhduar licencën për prodhim të energjisë elektrike ndërmarrjes KEK SH.A -TC “Kosova A” (vendimet për vazhdim licence: V_380_2011 i datës 30 shtator 2011; V_437_2012 i datës 01 tetor 2012; V_556_2013 i datës 06 shtator 2013; V_652_2014 i datës 03 tetor 2014; V_749_2015 i datës 16 korrik 2015; V_843_2016 i datës 03 tetor 2016 dhe V_1032_2018 i datës 24 shtator 2018, V_1185_2019 i datës 14 tetor 2019; V_1290_2020 i datës 30 shtator 2020;), duke obliguar të licencuarin që brenda periudhës së përcaktuar në pikën një (I) të dispozitivit të Vendimeve, ta sigurojë nga Ministria përkatëse Lejen Mjedisore të Integruar, dhe një kopje ta dërgojë në Rregullator.
- Me kërkesë të Rregullatorit, e po ashtu me qëllim të përmbushjes së dispozitave të licencës dhe obligimit të përcaktuar me ligjet në fuqi për Leje të Integruar Mjedisore, edhe gjatë këtij aplikimi për vazhdim licence, KEK SH.A nuk ka dorëzuar Lejen Mjedisore të Integruar, por ka dorëzuar në Rregullator VENDIMIN e lëshuar nga MMPHI për këtë çështje.
- Në dispozitivin e Vendimit të lëshuar nga MMPHI-ja të datës 27.09.2021, lidhur me këtë çështje thuhet se:
 - *Suspendohet për kohësisht për periudhë dyvjeçare aplikimi i normave të emisioneve dhe cilësisë së mjedisit në rastin e aplikimit të Korporatës Energjetike të Kosovës / TC “Kosova A” për pajisje me Leje Mjedisore të Integruar.*
 - *Oligohet Korporata Energjetike e Kosovës, pavarësisht afatit të dhënë në pikën 1 të Vendimit, për marrjen e masave për plotësimin e kushteve për përmbushjen e standardeve të përcaktuara në legjislacionin për mjedis.*
 - *Gjatë kësaj periudhe grupet punuese të Korporatës Energjetike të Kosovës / TC “Kosova A” dhe MMPHI të punojnë në hartimin e planit të përputhshmërisë me qëllim të përafrimit gradual me standardet vendore dhe ato të BE.*
 - *Inspektoriati i MMPH mund të ndalojë në çdo kohë punën e Korporatës Energjetike të Kosovës /TC Kosova A nëse konstaton se tejkalimi i normave mund të rrezikoj seriozisht shëndetin e popullatës dhe mjedisit.*
- Në po të njëjtin Vendim është edhe arsyetimi i lëshimit të vendimit, citoj: duke marrë parasysh faktin se Korporata Energjetike e Kosovës është Ndërmarrje Publike me interes vital për Kosovën veprimtaria e së cilës është në interes të përgjithshëm dhe se operimi i TC Kosova A është i domosdoshëm për sigurimin e furnizimit me energji elektrike në vend, duke kontribuar me 35 % të furnizimit me energji elektrike në konsumin vendor që është një prej faktorëve kryesor që ndikon në zhvillimin e gjithmbarshëm. Andaj bazuar në këtë dhe duke pasur parasysh se Korporata Energjetike e Kosovës, respektivisht TC Kosova A ka aplikuar për vazhdim licence për gjenerimin e energjisë në Zyrën e Rregullatorit për Energji, duhet të merret parasysh ky vendim gjatë procesit të vazhdim të licencës”.



- Rregullatori duke marrë parasysh këtë që u tha më lartë, dëshmitë e bashkëngjitura aplikacionit për vazhdim licence dhe dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.
- Licenca e lëshuar me datë 04 tetor 2006 (Nr. i Licencës ERO/Li_05/06_A), e modifikuar me 18.07.2012 (Nr. i licencës ZRRE/Li_05/12_A), e modifikuar me 06.09.2013 (Nr. i licencës ZRRE/Li_05/13_A), e modifikuar me 13.04.2017 (Nr. i licencës ZRRE/Li_05/17_A), vazhdohet dhe do të jetë e vlefshme sipas pikës I të dispozitivit të këtij Vendimi, me mundësi vazhdimi, nëse i licencuari aplikon për vazhdim licence **jo më vonë se gjashtë (6) muaj** para skadimit të afatit të licencës në pajtim me Nenin 15 të Licencës së lëshuar nga Rregullatori dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- Të gjitha dispozitat e licencës në fuqi me numër licence ZRRE/Li_05/17_A të lëshuar me datë 30 shtator 2020 mbeten në fuqi dhe ky Vendim i bashkëngjitet licencës së lëshuar me datë 30 shtator 2020.

IV. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

- Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK SH.A) - TC Kosova A
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji


Bordi i Rregullatorit:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Selman Hoti, Anëtar


Izet Rushiti, Anëtar


Lutfije Dervishi, Anëtare


Gani Buçaj, Anëtar